



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

**DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE
DHE INDUSTRIË**

Nr. 2635/prot.
1

Tiranë, më 04.03.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.971/1, datë 15.07.2016.

SHOQËRISË “VEGA” SH.P.K

Kthesa e Kamzës, Ish Scrat, Mëzes, Kashar, Tiranë.

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Vega” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.971/1, datë 15.07.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.1668/1 datë 28.02.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.2603 date 28.02.2019 dhe me shkresën nr. 1823, datë 01.03.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.2635 date 01.03.2019, është propozuar revokimi i lejes minerare nr.971/1, datë 15.07.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë, për arsye se:

- Nuk ka realizuar shfrytëzimin në përputhje me projektin e miratuar, pasi nuk ka zbatuar projektin e shfrytëzimit duke e oasur lartësinë e shkallës 48m nga 10-12 që është sipas kushtit teknik.
- Shfrytëzimi në pjesën veriore dhe lindore është jashtë zonës së dhene me leje shfrytëzimi.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “dh”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.971/1, datë 15.07.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë, që shoqëria juaj zotëron.**

Duhet të paguani si diferencë rehabilitimi shumën 386171 lekë, pasi nga 1332957 lekë që duhet të kishit paguar sipas sipërfaqes së prekur nga shfrytëzimi, keni paguar 946786 lekë.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.971/1, datë 15.07.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDESMINISTRI

ILIR BEJTJA

